

**VENDIM**  
**Nr.557, datë 3.8.2005**

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, TË VARËSISË STRUKTURE, ORGANIKËS DHE  
TË NUMRIT LIMIT TË PUNONJËSVE TË GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1.Struktura dhe varësia strukturore e Gardës së Republikës të jetë sipas skemës nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2.Organika e Gardës së Republikës të jetë sipas skemës nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3.Numri limit i punonjësve të Gardës së Republikës për vitin 2005, të jetë 1056 ( një mijë e pesëdhjetë e gjashtë) veta.

4.Ngarkohen Ministri i Rendit Publik dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**